



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna Klinë
Shërbimi për punë të Kuvendit
01Nr 06-32428 /2022
Klinë, me 13.09.2022

-Propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet të ndalura nga Debati me Publikun i mbajtur me datë 13.09.2022

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe konsultimi me publikun lidhur me :

1. Draft-buxhetin e Komunës së Klinës 2023-2025

-Lidhur me pikë të rendit të ditës referoj Ud. Drejtori i Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim z. Ajet Sejdiu, i cili theksoj se buxheti për vitin 2023-2025 është përgatitur duke respektuar ligjin për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë. Prezantoj buxhetin si në vijim: Buxheti për vitin 2023, Paga dhe mëditje 6,753,688 euro, Mallra dhe shërbime 1,660,000 euro, Komunalit 200,000 euro, Transfere dhe subvencione 400,000 euro, projekte Kapitale 4,037,907 euro, ndërsa totali i buxhetit për vitin 2023 është 13,051,595 euro.

-Po ashtu kishte sugjerime nga qytetaret që të parashihet ndihmë financiare për fermerët të cilët nuk mund t'i plotësojnë kushtet për përfitimim e subvencioneve të cilat ndahen nga ana e Ministrisë së Bujqësisë.

-Gjithashtu u kërkua që të parashihet në buxhet, rregullimi i rrugëve të cilat qojnë në varreza dhe mundësia e lidhjes së kontratës me ndonjë kompani për hapjen e varreve për shkak se çdo ditë e më shumë po paraqitet si problem.

-Nga banor të fshatit Gllarevë u kërkua që të parashihet buxhet për riparimin kanalizimit në lagjen Abazaj, Morina dhe Veselaj

-Po ashtu në fshatin Krushev e Madhe u kërkua që të hapet kanali i ujitjes i cili kalon në mes të fshatit, i cili gjatë muajve të dimrit paraqet problem për banoret ngase po vërshohen nga uji përmes atij kanali , gjithashtu u kërkua që të ndahet buxhet për rregullimin e ndriçimit dhe rregullimin e rrugëve në këtë fshat.



**Kryesuesi
Fadil Gashi**